



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2021:285453

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514967

C.nr.1337/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Naim Rekalii, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K., S.R., K.H., dhe R.S.nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson zyra e avokatëve F.G. dhe K.F.nga Prishtina, kundër të paditurës K., lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seance me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve B.K., S.R., K.H., dhe R.S.nga Vushtrria ashtu qe DETYROHET e paditura K., që:

-Paditësit B.K., në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim në shkallën prej 70 % të lartësisë se biletës, për periudhën kohore prej datës 17.12.2018 deri me 17.12.2021, për 600 ditë udhëtimi në punë, shumën prej 1,260.00 euro.

-Paditëses S.R. , në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim në shkallën prej 70 % të lartësisë se biletës, për periudhën kohore prej datës 17.12.2018 deri me 17.12.2021, për 600 ditë udhëtimi në punë, shumën prej 420.00 euro.

-Paditëses K.H. – në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim në shkallën prej 70 % të lartësisë se biletës, për periudhën kohore prej datës 17.12.2018 deri me 17.12.2021, për 600 ditë udhëtimi në punë, shumën prej 420.00 euro.

- Padiësit R.S. në emër kompensimit të shpenzimeve për udhëtim në shkallën prej 70 % të lartësisë së biletës, për periudhën kohore prej datës 17.12.2018 deri me 17.12.2021, për 46 ditë udhëtimi në punë, shumën prej 32.20 euro,

Të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 20.11.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

#### A r s y e t i m

Padiësit B.K., S.R., K.H., dhe R.S. nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë zyra e avokatëve F.G. dhe K.F. me seli të zyrës në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 20.12.2021, me të cilën kane kërkuar që të obligohet e paditura që për periudhën si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj shpenzimet e udhëtimit t gjate ditëve të punës kundër të paditurës K., bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe atë të vitit 2021 me arsyetimin se të njëjta i takojnë ndërsa e paditura nuk ia ka kompensuar.

Gjykata ia ka dërguar të paditurës aktvendimin për përgjigje në padi, ndërsa e paditura ka paraqitë përgjigje në padi duke e kundërshtuar kërkesën e padiëses me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar me datën 18.04.2017 është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e padiëses ta refuzoj të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se padiësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimet e lëshuara nga SH F “ GJ.K.Skënderbeu” në Pantinë, të datës 23.10.2023 për padiësit, kontestuese nuk ishte prania e padiësve në punë për ditët e pranisë në punë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjithashtu

kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura K. nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar nga agjencioni i transportit të udhëtimit “Beka Tours”, i datës 23.10.2023, për paditësin B.K., u vërtetua se çmimi i biletës së udhëtimit Vushtrri-Duboc-Beçiq dhe anasjelltas, kushton 3 euro për udhëtar, nga vërtetimi i lëshuar nga “Arti Tours Sh.P.K, e datës 22.03.2021, për paditësen S.R., u vërtetua se e njëjta udhëton 5 ditë në javë në relacionin Pantinë-Oshlan dhe anasjelltas dhe çmimi i biletës ditore një drejtim kushton 0.50 euro, kurse kthyesë kushton 1 euro, si dhe për paditësen K.H. u vërtetua se e njëjta udhëton 5 ditë punë në javë në relacionin Mitrovicë-Pantinë dhe anasjelltas, çmimi i biletës në një drejtim kushton 0.50 euro, kurse kthyesë kushton 1 euro, nga vërtetimi i lëshuar nga “Kombi Taxi Gjylazim Ibrhaimi”, u vërtetua se paditësi R.S. udhëton çdo ditë në relacionin Akrashticë-Vushtrri dhe anasjelltas me çmim 1 euro.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, ashtu që pasi vërtetoi çmimet e biletave si më sipër, paditësit të parë për 600 ditë të pranisë në punë, ia njohu shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 1,260.00 euro, duke llogaritur për 600 ditë të pranisë në punë 3.00€ të çmimit të biletës duke e shumëzuar me 0.70%=2.10€, 2.10€x600 ditë=1,260.00 euro, paditëses së dytë, ia njohu shpenzimet e udhëtimit në shumën prej 420.00 euro, duke llogaritur për 600 ditë të pranisë në punë 1.00€ të çmimit të biletës duke e shumëzuar me 0.70%=0.70€, 0.70€x600 ditë=420.00, paditëses së tretë, ia njohu shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 420.00, duke llogaritur për 600 ditë të pranisë në punë me 1.00€ të çmimit të biletës duke e shumëzuar me 0.70%=0.70€, 0.70€x600 ditë=420.00 euro, dhe paditësit

të katërt ia njohu shpenzimet e udhëtimit në shumën prej 32.20 euro, duke llogaritur për 46 ditë të pranisë në punë me 1.00€ të çmimit të biletës duke e shumëzuar me  $0.70\%=0.70\text{€}$ ,  $0.70\text{€}\times 46$  ditë= $32.20$  euro.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, ndërsa paditësi kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 01.12.2019 deri më 21.11.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 16.04.2021.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8%, Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në faktin se për shpenzimet e procedurës kontestimore është vendosur në marrëveshjen e arritur pranë ndërmjetësimit, në këtë gjykatë me nr.ND.1151/2023 të datës 13.11.2023 lidhur me inflacion dhe kualifikim/licencim, si dhe shpenzimet e procedurës.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.1337/2021, me datë 27.03.2024

Gj y q t a r i  
Naim Rekalio

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.